



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1757 /2025  
Data: 12.03.2025

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.02.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **KimeteKuka –Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Përfaqësuesi i OSB-së, Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.
4. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.
5. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
6. Raporti financiar për vitin 2024 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
7. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- me kërkesë të Ministrisë së Financave mbi vendimin për normat tatimore për vitin 2025 është kërkuar që në atë vendim të bëhet ndryshimi i preambulës sepse në kohën kur është miratuar vendimi për normat tatimore në fuqi ka qenë një ligj tjetër, ndërsa në dhjetorë të vitit 2024 është bërë plotësim ndryshimi i atij ligji. Vendimi mbetet i njëjti, normat tatimore mbeten ashtu siç janë të miratuara. Kërkoj që të hynë në rend të punës.

**Kryesuesi** thekson:- rishqyrtimi i vendimit me numër 01/Nr.9045/2024 për normat tatimore për vitin 2025 e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.
4. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.
5. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
6. Raporti financiar për vitin 2024 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
7. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
8. Ryshqyrtimi i vendimit me numër 01/Nr.9045/2024.
9. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- fillimisht më lejoni të shprehë ngushëllimet e mia për ndarjen nga jeta e isha asamblistit të kuvendit të komunës, njëherësh kryesues i komitetit për komunitete z.Mefail Suma. Materiali është voluminozë dhe janë tetëmbëdhjetë marrëveshje që i kemi nënshkruar me OJQ dhe Organizata të ndryshme që ne kemi bashkëpunim. Nuk kisha dashur me lexuar raportin për shkak të volumit të madh të punëve për vitin 2024 por nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerime mund të parashtroni. Po ashtu ju urojë muajin e bekuar të Ramazanit.

**Sherif Berisha** thekson:- raportet të cilat i dërgoni në kuvend janë raporte që nuk do të duhenin assesi të përcilleshin në kuvend se një drejtori komunale ka aq shumë gabime sa që duken që janë bërë sa për sy e faqe, si në drejtorinë e administratës e sidomos në drejtorinë e arsimit por duke mos përjashtuar edhe drejtoritë e tjera. Andaj ju kisha kërkuar që të jeni më të përgjegjshëm sa i përket kësaj pjese me qenë se jeni përfaqësues të drejtorive të caktuara dhe nuk po leni përshtypje të mirë me këtë drejtshkrim asnjëri nga ju. Sa i përket marrëveshjeve për vitin 2024 nuk shihet që ka ndonjë marrëveshje të re por janë vazhduar marrëveshjet e më hershme për bashkëpunim apo shërbime. Drejtoria e Administratës ka potencuar se janë ulur taksat për 10 shërbimet por mirë do të kishë qenë në këtë raport të ceket edhe për shumë shërbime tjera që janë ngritur taksat. Nuk është paraqitur qartë në tabelarë për punët e kryera sipas sektorëve sepse në qendrën për shërbim të qytetarëve i keni listuar numërimin e lëndëve në secilin sektorë, 5424 lëndë , ndërsa totali qenka 5542 lëndë. Kërkoj sqarim për këto shifra. Drejtorinë më të dështuar e keni drejtorinë për buxhet dhe financa nga vetë fakti që komuna jonë ka mbetur pa zyrtarë të lartë financiarë dhe ende nuk keni arritur ta bëni zgjidhjen. Jeni komunë e vetme që nuk është alokuar as buxheti për vitin 2025 e ndërkohë keni bërë planë tre mujorë të punës. Drejtorinë e arsimit e kisha lutur me pa vetë raportin të cilin e ka përcjell dhe a mundet me kuptuar se çka ka shënuar se aspak nuk ka asnjë ndarje të fjalëve në secilën fjali , ndërsa sa i përket gjendjes në arsim drejtori mundet me i renditur të arriturat por e dimë gjendjen dhe cilësinë e arsimit në komunën tonë . Sa i përket drejtorisë së shëndetësisë pjesëmarrjet televizive nuk janë ndonjë e arritur që ti paraqitni në raport dhe mirë kishte qenë që në raportet e sektorit të shëndetësisë të paraqitni gjendjen reale, jeni në vitin e katër të punës së juaj dhe ende nuk e dini se sa sektorë ka QKMF-ja . E keni paraqitur një tabelarë me një staf prej tridhjetë e tre persona e në realitet keni tridhjetë e një punëtorë në QKMF pra ende se keni idenë se sa punëtorë menaxhoni dhe pozitën e drejtorit e keni të lirë dhe të njëjtën e keni zëvendësuar qe katër vite me

infernierë. Me Islamik Relief i keni tre mjek të përgjithshëm dhe të gjithë e dinë që njëri nga ta është tejtë i padëshiruar për pacientët pra edhe këtu nuk e keni paraqitur gjendjen reale. Te ambulanca e fshatit Gorancë paska të shënuar kontrole dhe vizita shtëpiake , kërkoj sqarim për këtë çështje. Te shërbimet publike i drejtohem drejtorit se kur do të kemi ujë të pishëm , pse nuk është realizuar projekti i kanalit të hapur në fshatin Paldenicë dhe rregullimi i krojeve publike, shtimi i kapaciteti të ujit në Han të Elezit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- i kuptoj shqetësimet e juaja janë normale dhe në pozicionin e opozitës pavarësisht se artikulimi është shumë i dobët . Sa për dioninë tënde buxheti është alokuar dhe kemi filluar me procedura. Roli i një anëtari të kuvendit nuk është ndoshta sa për të thënë diçka por roli i një anëtari të kuvendit është një lloj katalizatori i qeverisjes lokale. Këto faqe nuk janë shkruar vetëm shkel e shko por këto marrëveshje kanë data se kurë janë nënshkruar dhe në bazë të këtyre marrëveshjeve bashkëpunojmë me OJQ-të dhe Organizata dhe këto marrëveshje nuk janë bërë para pesëmbëdhjetë viteve dhe për atë janë shënuar në raport.

**Natya Kalisi** thekson:-janë shënuar dhjetë shërbime për shkak se janë ulur dhjetë shërbime në drejtorinë e administratës me vendimin që është marr në kuvend. Sa i përket pjesës për te qendra për shërbime me qytetarë është një lëshim teknik pasi që numri total i lëndëve për vitin 2024 janë 10004 në total.

**Hisni Luri** thekson:- raportin e drejtorisë e kam përcjellë në mënyrën më të mirë të mundshme te komisioni përgjegjës që e grumbullon për me ua përcjell juve por çështja që nuk i ka ndarë është çështje e softëverit të cilin unë e kam një softëver pak më të ri dhe ata të cilin e përdorin ofisin më të vjetër ju ka grumbulluar. Nuk është përgjegjësia ime por ndoshta kur është shtypur ka dalur e bashkuar dhe është çështje teknike.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- i kam paraqitur të gjitha aktivitetet ku përfshihet edhe paraqitja televizive si aktivitet në kuadër të drejtorisë. Sa i përket stafit është paraqitur numri që i ka si pozita QKMF-ja në Han të Elezit. Për çështjen e shqetësimeve me mjekët të cilët i kemi përmes Islamik Reliefit jemi duke u marr dhe janë marr masa paraprake me mjekun në fjalë. Sa i përket shënimeve më të ulta në AMF kemi mungesë të stafit dhe janë ato shërbime të cilat i kanë marr pacientët.

**Arsim Dernjani** thekson:-sa i përket çështjes së investimeve të ujit është çështja e kohës dhe ndryshimi i ligjit të prokurimit publik dhe janë tre menaxher kryesorë të cilët e mbikëqyrin punën Amir Berisha , Durim Dernjani dhe Rraman Bushi dhe janë gati në fazën përfundimtare për shkak të kohës që nuk kanë mundur me përfunduar. Krojet publike nuk janë bërë për shkak se janë hequr si projekte nga kuvendi.

**Sherif Berisha** thekson:- është mirë që të ju tregoni qytetarëve se nuk kemi ujë të pishëm. Për te QKMF-ja nuk e di a jeni në dioni se në makinën larëse ku lahen mantilat e motrave lahen edhe gjokerët e komunës. Sa i përket materialit nga drejtorja e arsimit ashtu na e keni sjellë.

**Zaim Bela** thekson:- për mjekun që është me islamik Relief a nuk ka mundësi me marr masa ose me larguar ose me i dhënë më pak kompetenca për shkak se ka ankesa prej qytetarëve.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- te raporti i kryetarit të komunës përgjigjet janë shumë të sakta, të raportuara në projektet e tyre , shihet që më tepër po gjykohet drejtorja e shëndetësisë por më e mira e mundshme që është bërë në këto vite nuk është bërë në të kaluarën. Në QKMF punohet prej pastruesit e deri te drejtori i cili shumë suksesshëm e udhëheqë QKMF-në në Han të Elezit. Te drejtorja e arsimit është punuar si në nivelin e ndërtimit dhe në mënyrën digjitale që janë sjellë projektet për të mirën e nxënësve. Sa i përket drejtorisë së shërbimeve publike më tepër kemi kërkesa të dëmtimit të dritave, shportave të mbeturinave por në teren vazhdimisht ka dalë dhe defektet janë sanuar.

**Malik Berisha** thekson:-për vitin 2024 i keni 249 pozita për zyrtarë publik dhe a ka mundësi me u zëvendësuar në sektorë tjetër nëse lirohet një pozitë në arsim.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- programet buxhetore janë të ndara secila drejtori e ka në veti prej arsimit në shëndetësi nuk mundemi me bart pozita. Për çështjen e ujit të pishëm besojë që është e tepërt të me potencuar se a ka ujë të pishëm sepse ju nuk keni pasur ujë për tualet e jo për me pi, uji është i pishëm në shumicën e rasteve por disa herë e kam potencuar se kompleksi i qytetarëve për mos me pijë ujin është e drejtë e tyre. Unë e kom potencuar disa herë se Gjermania i ka rreth tetëdhjetë e pesë milionë banorë dhe nuk e di sa përqindje e vogël mund ta pinë ujin e qeshmave të tyre dhe çdo vend tjetër të Evropës, por është bërë revolucion në zgjidhjen e problemit të ujit. Sa i përket çështjes në shëndetësi ju potenconi se sipas informacioneve por informacionet në rrugë dhe në kafe nuk merren dhe nëse ka ndonjë shqetësim mund ta paraqitni sepse ka inspektorë që përkujdesën për këtë punë por fokusohu më shumë te zgjidhja e një problemi që e sheh si problem dhe jep alternativë. Sa i përket mjekut në QKMF janë marr masa duke u bazuar sipas ligjit. Për çështjen e lekturimit të dokumenteve ne nuk kemi lektorë për shkak të hapësirave të rekrutimit por mirë e shpjegoj drejtori i arsimit sepse është adekuat dhe tregojë pse ka ndodhur.

**Sherif Berisha** thekson:- sa i përket ujit mos të shkojmë në Gjermani se larg jemi por na e dimë se sa është investuar për çështjen e ujit në Han të Elezit në mandatin tënd si kryetarë. Në QKMF janë dy pozita të lira nuk e di se për këndë i runë drejtoresha. Unë prej gjithë juve kërkojë punë dhe disiplinë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### **3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.**

**Kryesuesi** thekson:- kuvendi i komunës gjatë vitit 2024 ka planifikuar që t'i mbajë dymbëdhjetë mbledhje. Gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta, një mbledhje solemne dhe atë me rastin e përvjetorit të themelimit të Komunës së Hanit të Elezit, që në këtë mbledhje shpalli qytetarë nderi për gjeneralin z.Kudusi Lame. Mbledhjet e kuvendit vazhdimisht janë monitoruar nga monitoruesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Vlen të theksohet se në bazë të monitorimit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2024 kemi pasur tre vendime dhe rregulloren për taksa komunale për vitin 2025 të kthyera për rishqyrtim, kurse të gjitha vendimet tjera që janë marr në kuvendin e komunës kanë qenë në përputhshmëri me ligjin. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe nga OSBE, përfaqësues të OJQ-ve. Vlen të theksohet se transparenca ka qenë e nivelit mjaft të mirë pasi që mbledhja është thirr me kohë dhe është publikuar me kohë ftesa për mbledhje. Transmetimi i mbledhjeve është bërë drejtë për drejt në Televizionin TV Festina. Bashkëpunimi me kryetarin e komunës dhe me ekzekutivin ka qenë i nivelit shumë të mirë. Mbledhjet e kuvendit të komunës vazhdimisht sipas rregullores së punës ju ka paraparë mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa në të cilat mbledhje në shumicën e rasteve jemi dakorduar unanimisht për pikat e rendit të punës për kuvend. Punën e kuvendit të komunës gjatë këtij viti e ka përcjell një frymë e bashkëpunimit si me pozitën ashtu edhe me opozitën por vlen të theksohet se kuvendi i komunës në vitin 2024 ka miratuar buxhetin për vitin 2025. Mbledhjet e kuvendit kanë qenë të hapura për publikun por edhe pse vazhdimisht i kemi njoftuar qytetarët për një të drejtë të tyre për pjesëmarrje, kemi pas raste ku qytetarët kanë marr pjesë në mbledhje të kuvendit. Na mbetet për detyrë që në vitin 2025 t'i inkurajojmë qytetarët që të marrin pjesë në punimet e kuvendit. Kuvendi i komunës gjatë vitit 2024 ka miratuar 33 vendime dhe dy plotësim ndryshime të rregullores dhe plotësim ndryshimin e statutit të QKMF-së, që në krahasim me vitin e kaluar kuvendi i komunës ka miratuar 55 vendime dhe 2 rregullore. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- sa i përket raportit të kuvendit për vitin 2024 është bërë një punë e mirë dhe falenderojë kryesuesin e kuvendit për bashkëpunimin që e ka mbajtur me të gjitha subjektet politike.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024**

#### **4. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyrë Kalisi** thekson:- kjo rregullore ka qenë në shqyrtim në mbledhjen e dymbëdhjetë të kuvendit të komunës të vitit 2024 dhe në muajin janar është mbajtur debati publik me qytetarët. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA DRAFT RREGULLORJA KOMUNALE PËR MENAXHIMIN TË PASURISË JOFINACIARE KOMUNA HANI I ELEZIT**

#### **5. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hyriete Isufi** thekson:- a kemi pjesëmarrje në dy regjionet kur të bëhen të përbashkëta. Si do ta ketë pjesëmarrjen komuna e Hanit të Elezit.

**Arsim Dernjani** thekson:- është plan që është hartuar nga ekspertët e Gizit dhe është gjithëpërfshirës në regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt pra është i përbashkët dhe për çdo çështje që bëhet aty kemi pjesëmarrje edhe ne si komunë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U APROVUA PLANI NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK**

#### **6. Raporti financiar për vitin 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

#### **7. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.**

**Nexhmedin Daci** thekson:- gjatë viti 2024 kemi pasur gjithësejtë shtatë aplikime për legalizim të ndërtimeve pa leje dhe gjithë këto aplikuesë janë pajisur me leje të legalizimit. Të hyra kanë realizuar në shumë prej 306.00 € në emër të taksës komunale për legalizim. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Zaim Bela** thekson:- shumë qytetarë të komunës kanë bërë kërkesë për ndërtim ku nuk është zona ndërtimore dhe nuk janë pajisur me leje, ndërsa shtëpinë e ka ndërtuar për shkak se aty ka pasur pronë. A mundet ai qytetarë në bazë të këtij ligji me kërkuar për me bërë legalizimin e shtëpisë së banimit.

**Nexhmedin Daci** thekson:- me ligj është e përcaktuar se cilat objekte munden me u legalizuar të cilat janë ndërtuar deri në vitin 2018.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 8. Ryshqyrtimi i vendimit me numër 01/Nr.9045/2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin., nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## MIRATOHET RISHIKIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.9045/2024

### 9.Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Erbllin Meliqi** thekson:-kur është miratuar buxheti i komunës kemi pasur disa projekte për të cilët kam diskutuar dhe tu kam drejtuar edhe me shkrim por u dhanë disa përgjigje që për vitin 2025 janë mundësitë e vogla por kërkoj informacion se sa janë mundësitë që me u kryer ato projekte. Për rregullimin e shkallëve te varrezat e qytetit a keni planifikuar me i rregulluar gjatë vitit 2025.

**Ajnure Thaçi** thekson:- cilat janë investimet e fundit të cilat i keni bërë nëpër shkolla.

**Nexhmedin Daci** thekson:- sa i përket rregullimit të shkallëve te varrezat e qytetit nuk kemi mjete financiare por do të shikohen mundësitë përmes donacioneve.

**Hisni Luri** thekson:- punët të cilat i kemi kryer i keni te raporti i kryetarit të komunës për vitin 2024 te drejtoria e arsimit, ndërsa për punët të cilat do ti kemi është shpallur procedura për tabelat smart dhe rregullimi i pompave termike te institucioni Ardhmëria.

**Sherif Berisha** thekson:-pse nuk ju bëhet përshkrimi punëtorëve të tjerë të QKMF-së por ju ka bërë vetëm një motrës.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- te rruga “Imer Vila” ndriçimi publikë nuk është në funksion qe shtatë ditë. A keni pasur bisedime me pronarët e barnatoreve që një barnatore të punon njëzet e katër orë.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- çështja e përshkrimi e vendeve të punës ka të bëjë me kontratat që duhet të ripërtërihen e që është në proces në vazhdimësi. Për orarin e barnatoreve jemi duke pritur drejtoreshën e zhvillimit ekonomik për shkak se do të bëhet një rregullore nga agjensioni që do të jetë unike për tërë Kosovën.

**Arsim Dernjani** thekson:- për ndriçimin jemi në procedurë dhe me datë katërmëdhjetë mars do të dihet se kush do ta merr tenderin për me rregulluar ndriçimin por për problemin që është në pjesën ka Uji i Thartë do të mundohem me rregulluar sa ma shpejtë.


**Xhevahir Dernjani** thekson:- projektet të cilat janë për vitin 2025 kërkoj që të kryhen në afatet siç janë paraparë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55.

Procesmbajtësi  
Aydi Bushi



Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

